



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

VENDIM
Nr.134, datë 21.09.2019

**PËR LISTËN PËRFUNDIMTARE TË RENDITJES SË KANDIDATËVE PËR
GJYQATAR NË GJYKATËN KUSHTETUESE, NË VENDIN VAKANT, VAKNCË E
PLOTË, TË SHPALLUR NGA KUVENDI I REPUBLIKËS NË DATËN 04.03.2019**

Në mbështetje të pikës 1 të nenit 125 dhe të pikës 1 të nenit 149/d të Kushtetutës, të pikës 4 të nenit 7/c të ligjit nr. 8577/2000, të pikës 5 të nenit 229, të pikës 2 të nenit 239 dhe 240 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", si edhe të pikave 68 , 70 dhe 72 të vendimit nr. 5 datë 02.04.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi "Për kriteret dhe procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, pasi dëgjoi relatimin e relatores, znj. Fatjona Memçaj dhe si e bisedoi çështjen, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të renditjes së kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, në vendin vakant, vakancë e plotë, të shpallur nga Kuvendi i Republikës në datën 04.03.2019, si më poshtë :

- | | |
|---------------------|-------------|
| 1) Arta Vorpsi | 89.642 Pikë |
| 2) Fiona Papajorgji | 88.785 Pikë |
| 3) Elsa Toska | 85.428 Pikë |

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e përcaktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

KRYETARI

Ardian DVORANI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

VENDIM

Nr. 135, datë 21.09.2019

**PËR MIRATIMIN E RAPORTIT PËR RENDITJEN E KANDIDATËVE TË LEJUAR
PËR PLOTËSIMIN E VENDIT VAKANT TË KRIJUAR NË GJYKATËN
KUSHTETUESE, VAKANCË E PLOTË, TË SHPALLUR NGA KUVENDI I
REPUBLIKËS NË DATËN 04.03.2019**

Në mbështetje të pikës 1 të nenit 125 dhe të pikës 1 të nenit 149/d të Kushtetutës, të pikës 4 të nenit 7/c të ligjit nr. 8577/2000 dhe të pikës 5 të nenit 229 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si edhe të pikave 71 dhe 72 të vendimit nr. 5 datë 02.04.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi “Për kriteret dhe procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

VENDOSI:

1. Miratimin e Raportit për Renditjen e Kandidatëve të Lejuar për Plotësimin e Vendit Vakant të krijuar në Gjykatën Kushtetuese, Vakancë e Plotë, të Shpallur nga Kuvendi i Republikës në datën 04.03.2019
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e përcaktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

KRYETARI

ARDIAN DVORANI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

RAPORT

**PËR RENDITJEN E KANDIDATËVE TË LEJUAR PËR PLOTËSIMIN E VENDIT
VAKANT TË KRIJUAR NË GJYKATËN KUSHTETUESE, VAKANCË E PLOTË,
TË SHPALLUR NGA KUVENDI I REPUBLIKËS NË DATËN 04.03.2019**

Në përfundim të afatit të shpalljes për hapjen e procedurave të aplikimit, Kuvendi i Republikës, me shkresën nr. 1446 prot, datë 04.04.2019 ka përcjellë pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi listën e kandidatëve që kanë shprehur interesin për kandidim për plotësimin e vendit vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e plotë, të krijuar për shkak të përfundimit të mandatit të gjyqtarit Bashkim Dedja.

Shkresa përcjellëse, së bashku me dokumentacionin e paraqitur nga kandidatët është dorëzuar dhe administruar pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi në datën 04.04.2019, me nr. 61 prot.

Për plotësimin e këtij vendi vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese kanë shprehur interesin për të kandiduar 9 kandidatë: (1) *Arta Vorpsi*, (2) *Avni Shehu*, (3) *Elsa Toska*, (4) *Fiona Papajorgji*, (5) *Ilir Mustafaj*, (6) *Klodian Rado*, (7) *Konstandin Kazanxhi*, (8) *Mitat Dautaj*, dhe (9) *Valbona Bala (Pajo)*.

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, i zgjedhur me short nga Kuvendi në datën 7 Dhjetor 2018, sipas Kushtetutës dhe ligjit, është ngarkuar me ushtrimin e kompetencave dhe përgjegjësi të tij, për vitin kalendarik 2019.

Në kushtet kur, Këshillat e mëparshëm nuk kishin përgatitur dhe miratuar rregullat e brendshme dhe aktet e tjera nënligjore normative të deleguara me ligj, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2019 është gjendur në pamundësi për të filluar dhe zbatuar menjëherë procedurat e verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe të renditjes së kandidaturave për të gjitha vendet vakante që ishin krijuar në lidhje me të gjithë përbërjen e Gjykatës Kushtetuese dhe për të cilat organet e emërtesës kishin dërguar pranë Këshillit lista të kandidatëve dhe dokumentacionin përkatës.

Në të tilla rrethana, përveç masave të tjera të shumta organizative dhe administrative për përgatitjet e domosdoshme në funksion të zbatimit e mbështetjes së procedurave të verifikimit, vlerësimit dhe renditjes së kandidaturave, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka filluar menjëherë edhe veprimtarinë e tij me përgatitjen, diskutimin dhe miratimin e kuadrit rregullator dhe nënligjor të kërkuar sipas ligjit.

Me vendimin nr. 1, datë 08.02.2019, Këshilli ka miratuar aktin *“Rregullore e brendshme për funksionimin e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi”*.

Me vendimin nr. 2, datë 15.02.2019, Këshilli ka miratuar aktin nënligjor normativ *“Për procedurën e shortit të caktimit të relatorëve për pozicionet vakante në çdo institucion”*.

Me vendimin nr. 4 datë 11.03.2019, Këshilli ka miratuar aktin nënligjor normativ *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*.

Me vendimin nr. 5, datë 02.04.2019, Këshilli ka miratuar aktin nënligjor normativ *“Për kriteret dhe procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*.

Me vendimin nr. 51 datë 21.06.2019, Këshilli ka miratuar *Metodologjinë për Vlerësimin dhe Caktimin e Pikëve për Renditjen e Kandidatëve për Gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese*.

Me vendimin nr. 52 datë 21.06.2019, Këshilli ka miratuar *Metodologjinë për Vlerësimin dhe Caktimin e Pikëve për Renditjen e Kandidatëve për Inspektor i Lartë i Drejtësisë*.

Ashtu sikurse përcakton ligji dhe aktet nënligjore normative të sipërcituara, dërgimi pranë organeve të emërtesës të renditjes së të gjithë kandidatëve të lejuar për secilin vend vakant, ku gjenden edhe tri kandidatë e renditur në tri vendet e para sipas Kushtetutës dhe ligjit, është rrjedhojë e realizimit:

- *së pari*, të procedurës së verifikimit dhe kontrollit të plotësimit të kushteve të kandidimit për secilin kandidat dhe;
- *së dyti*, të procedurës së vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve të lejuar për kandidim, në secilin vend vakant.

Prandaj, në përfundim të diskutimit dhe miratimit të kësaj pakete normative dhe me hyrjen e saj në fuqi, në zbatim të nenit 125 dhe 149/d të Kushtetutës, të nenit 7/c të ligjit nr.8577/2000, të nenit 229, 235 e vijues të Ligjit nr. 115/2016 *“Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”*, si edhe të pikës 98 të aktit nënligjor normativ, Vendimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi me nr. 4 datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në mbledhjen e zhvilluar në datën 05.04.2019, vendosi fillimin e procedurave të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes të kandidatëve që kanë shprehur interesin për vendet vakante të krijuara në Gjykatën Kushtetuese.

Në zbatim të nenit 228 të Ligjit nr. 115/2016 dhe të pikave 5, 27 deri 37 dhe 41 të aktit nënligjor normativ, Vendimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 2 datë 15.02.2019 *“Për procedurën e shortit të caktimit të relatorëve për pozicionet vakante në çdo institucion”*, si edhe të pikës 4 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, në të njëjtën ditë të mbledhjes së zhvilluar në datën 05.04.2019, është realizuar edhe procedura për caktimin me short të relatorëve për secilin nga vendet vakante të krijuara në Gjykatën Kushtetuese dhe për Inspektor i Lartë i Drejtësisë.

Sipas pikave 2 dhe 3 të nenit 228 të ligjit nr. 115/2016 shorti për caktimin e relatorit organizohet përmes sistemit të administrimit të çështjeve të Gjykatës së Lartë. Përfundimisht, në qoftë se sistemi elektronik nuk funksionon, shorti mund të kryhet manualisht.

Në zbatim të ligjit, Këshilli ka njoftuar Gjykatën e Lartë për kohën e realizimit të shortit dhe mundësinë e organizimit të tij përmes sistemit elektronik të administrimit të çështjeve të Gjykatës së Lartë.

Gjykata e Lartë ka njoftuar Këshillin, duke paraqitur edhe një raport teknik me shkrim të sektorit të teknologjisë së informacionit, nëpërmjet të cilit shpjegohet dhe konfirmohet që programi i sistemit elektronik të administrimit të çështjeve të kësaj Gjykate nuk e mundëson realizimin e një procedure shorti lidhur me identitete funksionarësh që nuk janë gjyqtarë apo këshilltarë të kësaj Gjykate dhe për lloje çështjesh që nuk kanë natyrë gjyqësore.

Këshilli, pasi u njoh dhe diskutoi lidhur me pamundësinë teknike të realizimit të shortit në rrugë elektronike, me vendim të ndërmjetëm të mbledhjes së tij të datës 05.04.2019, vendosi të realizojë shortin në formën manuale, me praninë e anëtarëve të Këshillit, Avokates së Popullit dhe përfaqësuesve të subjekteve të ftuar sipas ligjit.

Në vijim, sipas rezultatit të shortit manual të realizuar nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, lidhur me vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e plotë, të shpallur nga Kuvendi i Republikës në datën 04.03.2019, relatore për ndjekjen e procedurave të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidaturave, është caktuar anëtarja e Këshillit, znj. Fatjona Memçaj.

Sipas procedurave të parashikuara në ligj dhe në aktet normative të miratuara nga KED, Këshilli ka filluar dhe ndjekur procedurat e verifikimit të përmbushjes së kushteve ligjore për kandidim njëherazi për të gjitha pozicionet vakante të krijuara në Gjykatën Kushtetuese dhe për secilën kandidaturë, përfshirë edhe të atyre që kanë kandiduar në vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e plotë, të shpallur nga Kuvendi i Republikës në datën 04.03.2019.

Për realizimin e procedurave të verifikimit të kandidaturave, përveç veprimeve verifikuese të kryera nga vetë Këshilli bazuar në informacionin e hollësishëm dhe voluminoz të dërguar nga institucione publike dhe private sipas kërkesave të Këshillit, ushtrimi i kontroleve të thelluara për pasurinë, integritetin dhe kushtet e tjera ligjore është realizuar edhe nga disa institucione të tjera, si ILDKPKI, DSIK, agjencitë informative, Ministria e Brendshme, AIDSSH, KLGJ, KLP etj., të cilat, i kanë përcjellë Këshillit raportet, të dhënat dhe gjetjet përkatëse.

Gjithashtu, në datën 05.04.2019, me anë të një njoftimi publik, i cili është përcjellë edhe nga të gjitha mjetet e masmedias, Këshilli i është drejtuar publikisht me një thirrje-kërkesë të gjitha institucioneve publike, organizatave dhe shoqërisë civile, MEDIA-s dhe publikut, për të përcjellë opinione, të dhëna dhe informacione në lidhje me kandidatët.

Këshilli publikisht ka mbajtur qëndrimin se ky njoftim nuk ishte thjesht përmbushje të një detyrimi ligjor kundrejt publikut sipas përcaktimeve të nenit 7/c pika 5 të ligjit nr. 8577/2000 etj.. KED synon të garantojë një proces të rregullt ligjor, transparent, me integritet dhe të besueshëm dhe është shprehur tërësisht i angazhuar për të vlerësuar dhe mirëpritur kontributin e secilit prej tyre, duke marrë përsipër shqyrtimin me vëmendje të veçantë, objektivitet dhe profesionalizëm, në funksion të verifikimit të gjithanshëm dhe sa më të

thelluar të integritetit të kandidatëve, si dhe për të mundësuar përzgjedhjen mes tyre, të kandidatëve bazuar në meritat profesionale dhe morale. Gjithsesi, konstatohet se pothuajse nuk ka pasur opinione dhe informacione të përcjella prej tyre pranë Këshillit.

Nga ana tjetër, në zbatim të ligjit dhe akteve nënligjore normative, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka shqyrtuar të gjitha raportet dhe informacionet e dërguara nga institucionet publike dhe subjektet private, sikurse edhe ato të depozituara nga vetë kandidatët në kohën e aplikimit për vendet vakante pranë organeve të emërtesës apo të sjella pranë Këshillit prej tyre, kryesisht ose në përgjigje të kërkesave të Këshillit.

Në përfundim të procedurave të verifikimit të plotësimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka shqyrtuar në mbledhjet e tij gjetjet në procedurat e verifikimit edhe për të gjithë kandidatët që kanë shprehur interesin për plotësimin e vendit vakant, vakancë e plotë, për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të krijuar për shkak të përfundimit të mandatit të gjyqtarit Bashkim Dedja, të shpallur nga Kuvendi i Republikës në datën 04.03.2019.

Në lidhje me kandidatët që kanë shprehur interes për plotësimin e këtij vendi vakant në Gjykatën Kushtetuese, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka disponuar, sipas rastit, përfundimin e procedurës së verifikimit të kandidaturës, ndalimin e kandidimit ose lejimin e kandidimit.

Më konkretisht, KED ka vendosur përfundimin e procedurës së verifikimit të kandidaturës, për shkak të tërheqjes nga kandidimi, për kandidatët si më poshtë:

1. Avni Shehu – vendimi nr. 40, datë 24.05.2019;
2. Mitat Dautaj – vendimi i KED nr. 18, datë 10.05.2019.

KED ka vendosur ndalimin e kandidimit, për kandidatët si më poshtë :

1. Ilir Mustafaj – vendimi nr. 68, datë 24.07.2019;
2. Klodian Rado - vendimi i KED nr.90, datë 30.07.2019;
3. Konstandin Kazanxhi – vendimi i KED nr.39, datë 24.05.2019;
4. Valbona Bala (Pajo) - vendimi nr.86, datë 30.07.2019;

KED ka vendosur lejimin e kandidimit, për kandidatët si më poshtë :

1. Arta Vorpsi – vendimi i KED nr.56, datë 24.07.2019 ;
2. Elsa Toska – vendimi i KED nr. 105, datë 30.07.2019 ;
3. Fiona Papajorgji – vendimi i KED nr. 62, datë 24.07.2019.

Në pikën 1 të nenit 125 të Kushtetutës parashikohet se:

“Gjykata Kushtetuese përbëhet nga 9 anëtarë. Tre anëtarë emërohen nga Presidenti i Republikës, tre anëtarë zgjidhen nga Kuvendi dhe tre anëtarë zgjidhen nga Gjykata e Lartë. Anëtarët përzgjidhen ndërmjet kandidatëve të renditur në tri vendet e para të listës nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, sipas ligjit.”.

Ndërsa në pikën 1 të nenit 149/d të Kushtetutës, parashikohet se:

“Këshilli i Emërimeve në Drejtësi kryen verifikimin e kushteve ligjore dhe vlerësimin e kriterëve profesionale e morale të kandidatëve për Inspektor të Lartë të Drejtësisë, si dhe të

kandidatëve për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi shqyrton dhe rendit kandidatët sipas meritës profesionale. Renditja e kandidatëve nuk është e detyrueshme, me përjashtim të rastit kur nuk arrihet të emërohet kandidati.”.

Në zbatim të këtyre dispozitave kushtetuese, kompetencat dhe përgjegjësitë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi janë që të kryejë:

- *së pari*, procedurën e verifikimit të plotësimit të kushteve ligjore të kandidimit;
- *së dyti*, në lidhje me kandidatët e lejuar për kandidim, KED kryen vlerësimin e tyre bazuar në kriteret ligjore mbi meritat profesionale, morale dhe administrative të kandidatëve për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese;
- *së treti*, mbi bazën e këtij vlerësimi, KED bën edhe pikëzimin e meritave për secilin kandidat;
- *së katërti*, KED përgatit dhe miraton listën përfundimtare të renditjes së të gjithë kandidatëve të lejuar për kandidim.

Në krye të kësaj liste përfundimtare të miratuar nga KED, gjenden edhe kandidatët e renditur në tri vendet e para, ndërmjet të cilëve, sipas parashikimeve të Kushtetutës dhe ligjit nr. 8577/2000, organi përkatës i emërtesës ka detyrimin të përzgjedhë gjyqtarin e ri të Gjykatës Kushtetuese.

Në pikën 4 të nenit 7/c të ligjit të posaçëm me nr. 8577/2000 parashikohet se:

“3. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, pas vlerësimit të kushteve dhe të kriterëve të emërimit, brenda 10 ditëve nga zhvillimi i mbledhjes harton një listë përfundimtare duke renditur kandidatët. Nëse ka më shumë se një vend vakant, Këshilli harton dy lista të veçanta, një prej të cilave është me kandidatët që vijnë nga radhët e gjyqësorit. Lista shoqërohet nga një raport me shkrim ku analizohet plotësimi i kushteve dhe kriterëve ligjore për secilin kandidat. Raporti i arsyetuar, pasi miratohet me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, publikohet.”

Edhe në pikën 5 të nenin 229 të ligjit nr. 115/2016 parashikohet se:

“5. Në përfundim të procesit të verifikimeve, sipas pikës 4, të këtij neni, Këshilli interviston kandidatët që plotësojnë kushtet ligjore, bën renditjen e tyre sipas kriterëve të parashikuara në nenin 240, të këtij ligji, dhe harton një raport ku arsyetohet këtë renditje.”

Në zbatim të këtyre dispozitave ligjore, kompetencë dhe përgjegjësi e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi është edhe hartimi i Raportit në lidhje me procedurën e ndjekur për verifikimin dhe vlerësimin e kandidaturave, si edhe në lidhje me arsyetimin e renditjes së të gjithë kandidatëve të lejuar për kandidim, ku evidentohen edhe ata të renditur në tri vendet e para mes të cilëve përzgjedhin organet e emërtesës. Ky Raport bazohet dhe referon në arsyetimet e hollësishme që përmbajnë, për secilin kandidat të lejuar:

- a) vendimi përkatës i lejimit të kandidimit dhe
- b) vendimi përkatës i vlerësimit dhe pikëzimit të kandidatit/es të lejuar për kandidim.

Këshilli vlerëson se arsyetimi në Raport për renditjen e kandidatëve sipas dispozitave ligjore të sipërcituara, duhet të reflektojë hapat dhe mënyrën me të cilën KED ka kryer vlerësimin dhe pikëzimin që i ka bërë secilit kandidat lidhur me meritat profesionale, morale dhe organizative, bazuar në kriteret e vlerësimit, peshën dhe rëndësinë e tyre sikurse parashikohen në ligj dhe aktet normative që ka miratuar Këshilli.

Sipas ligjit, jo vetëm vlerësimi individual i secilit kandidat, por edhe renditja e tyre përfundimtare, nuk realizohen nëpërmjet “krahimit” të meritave të kandidatëve përkundrejt njëri-tjetrit. Për rrjedhojë edhe arsyetimi i Raportit lidhur me renditjen e kandidatëve nuk mund të përmbajë konstatime ose opinione të natyrës krahasuese ndërmjet kandidatëve të renditur. Ligji nuk i njeh KED ndonjë kompetencë apo diskrecion të tillë.

Përkundrazi, kompetenca dhe detyrimi i Këshillit është të vlerësojë dhe pikëzojë secilin kandidat individualisht, bazuar në meritat e tij/saj individuale profesionale, morale dhe administrative, nisur nga shqyrtimi dhe analiza objektive dhe profesionale e të dhënave konkrete që rezultojnë nga dokumentacioni dhe intervista përkatëse me kandidatin/en, për secilin kriter vlerësimi të parashikuar në nenin 7/a të ligjit nr. 8577/2000 dhe në nenin 240 të ligjit nr. 115/2016, të rregulluar më hollësisht nga vendimi nr. 5 datë 02.04.2019 “*Për kriteret dhe procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, si edhe nga orientimet për vlerësimin e pikëzimit që ky Këshill ka miratuar për qëllime të uniformizimit të qëndrimeve të tij dhe të transparencës së këtij procesi vlerësimi e pikëzimi nëpërmjet Metodologjisë përkatëse të miratuar me vendimin nr. 51 datë 21.06.2019.

Prandaj, për secilin kandidat të lejuar, KED ka disponuar me vendim të veçantë, duke arsyetuar vlerësimin e tij për secilin kriter ligjor vlerësimi dhe duke i përcaktuar pikëzimin përkatës. Në përfundim të arsyetimit dhe pikëzimit për të gjitha kriteret e vlerësimit, KED ka disponuar për vlerësimin në tërësi, duke përcaktuar pikëzimin e kandidatit/es si rezultat i totalit të pikëzimit të caktuar për secilin kriter vlerësimi.

Arsyetimi për vlerësimin dhe pikëzimin e kandidatëve për secilin kriter ligjor është rezultati i vlerësimit të përbashkët, kolegjal, të anëtarëve të KED. Sipas ligjit dhe rregullave më të hollësishme të aktit normativ, vendimi i KED nr. 5 datë 21.06.2019, në fazën e bisedimit të vlerësimit të kandidaturës në shqyrtim, secili anëtar i Këshillit arsyeton mendimin e tij dhe deklaron pikëzimin përkatës për secilin kriter vlerësimi. Ndërsa pikëzimi total i kandidaturës e që rezulton edhe në dispozitivin e vendimit të KED, është rezultati aritmetik nga veprimi i mbledhjes së totalit të pikëzimit të dhënë nga secili anëtar i Këshillit pjesëtuar me numrin e anëtarëve të Këshillit.

Për rrjedhojë, edhe arsyetimi i vlerësimit të KED për secilin kriter, duke pasur parasysh qëndrimet e secilit prej anëtarëve të KED, njëkohësisht reflekton rezultanten e përbashkët të këtyre qëndrimeve dhe arsyetimeve, të konvertuara në pikëzimin përkatës të përbashkët të kandidatit për secilin kriter. Rast pas rasti, nëse vlerësimi dhe pikëzimi i një apo disa anëtarëve të Këshillit, lidhur me një a më shumë prej kriterëve të vlerësimit, është i kundërt apo dukshëm i ndryshëm nga ai i disa anëtarëve të tjerë të Këshillit, arsyetimi përkatës i ndryshëm i këtyre anëtarëve i bashkëlidhet vendimit kolegjal të vlerësimit dhe pikëzimit të kandidaturës.

Duke pasur parasysh këto veçanti të procedurës së vlerësimit dhe pikëzimit të kandidaturave nga KED si organ kolegjal dhe si rezultat i mbledhjes së vlerësimeve individuale të secilit anëtar të tij e që janë jo domosdoshmërisht të njëjta me njëra tjetrën, Këshilli vlerëson se mënyra e duhur e pasqyrimit të vlerësimeve dhe pikëzimit të kandidatëve në këtë Raport të arsyetuar për efekt të renditjes së tyre në secilin vend vakant ku kandidati merr pjesë, është ajo e referimit në vendimin përkatës të KED për vlerësimin dhe pikëzimin e secilës kandidaturë, vendime që përmbajnë arsyetim të hollësishëm mbi vlerësimin e meritave të kandidatëve dhe pikëzimin e tyre në tërësi dhe për secilin kriter ligjor vlerësimi.

Nisur nga këto veçanti të procedurës së vlerësimit, pasqyrimi në këtë Raport i çfarëdo forme përmbledhjeje të arsyetimit shumë të hollësishëm që përmbajnë vetë vendimet përkatëse të vlerësimit dhe pikëzimit, në vend të lehtësimit të punës së organit të emërtesës dhe transparencës publike do të prodhonte efektin e kundërt.

Ndërkohë, KED vlerëson se do të përbënte përsëritje të panevojshme dhe do të vështirësonte kuptimin dhe përmbajtjen e Raportit, nëse arsyetimet e përmbajtura në vendimet përkatëse të verifikimit dhe atyre të vlerësimit të kandidaturave do të përsëriteshin integralisht në tekstin e këtij Raporti.

Sikurse parashtrohet më sipër, në përfundim të procedurave të verifikimit të plotësimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit të të gjithë kandidatëve për këtë vend vakant në Gjykatën Kushtetuese, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka vendosur lejimin e kandidimit, për kandidatët si më poshtë :

- Arta Vorpsi
- Elsa Toska
- Fiona Papajorgji

Vendimet përkatëse të KED për lejimin e kandidimit, për secilin nga të tre kandidatët e lejuar, përmbajnë përshkrimin e hollësishëm të të dhënave dhe gjetjeve në procedurën e verifikimit të kandidaturës, si edhe analizë e arsyetimit të hollësishëm mbi procedurat e ndjekura dhe për plotësimin e secilit kusht dhe kriter ligjor kandidimi që parashikohen nga Kushtetuta, ligji nr. 8577/2000 dhe ligji nr. 115/2016. Këto vendime janë të publikuar në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, pjesa e posaçme për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi. Ndërkohë, kopje e këtyre vendimeve i bashkëlidhen këtij Raporti.

Në përfundim të procedurave të verifikimit të plotësimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit të të gjithë kandidatëve që janë kandiduar për këtë vend vakant në Gjykatën Kushtetuese, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi realizoi procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe të renditjes së kandidatëve të lejuar për kandidim.

Kompetenca e KED për vlerësimin e kandidatëve të lejuar për kandidim, si edhe ndonjë element i kriterëve të vlerësimit përcaktohen drejtpërdrejt nga nenet 125 dhe 149/d të Kushtetutës. Ndërkohë, kriteret e tjera ligjore të vlerësimit të kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese përcaktohen dhe listohen në nenin 7/a të ligjit të posaçëm nr.8577/2000, si edhe në nenin 240 të ligjit nr. 115/2016.

Nga ana tjetër, Kushtetuta dhe ligji i posaçëm nr. 8577/2000, parashikojnë vetëm detyrën e KED për të realizuar renditjen e kandidatëve që janë verifikuar paraprakisht për plotësimin e kushteve ligjore të kandidimit, por nuk parashikojnë si element konkret edhe pikëzimin si një mënyrë e përzgjedhur për të reflektuar arsyetimin e KED lidhur me renditjen e kandidatëve dhe për ta materializuar këtë vlerësim në renditje nëpërmjet këtij elementi objektiv.

Pikëzimi, i cili është rrjedhojë e arsyetimit për vlerësimin e meritave të kandidatit për secilin kriter ligjor, parashikohet shprehimisht në pikën 2 të nenit 229 të ligjit nr. 115/2016. Gjithashtu, kjo dispozitë si edhe pika 6 e nenit 240 të këtij ligji i delegojnë Këshillit detyrimin për të përgatitur dhe miratuar rregulla të hollësishme jo vetëm për procedurën e vlerësimit të kandidaturave, por edhe për rregullimin më të hollësishëm të kriterëve ligjore të

vlerësimi, duke pasur parasysh rëndësinë dhe peshën specifike të tyre, shpërndarjen e pikëve dhe caktimin e pikëzimit maksimal për secilin kriter dhe në tërësi, përcaktimin e mënyrave, llojeve dhe burimeve dokumentare e bisedimore të vlerësimit.

Këto rregulla të hollësishme parashikohen në vendimin me karakter normativ nr. 5 datë 02.04.2019 *“Për kriteret dhe procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*. Sipas natyrës, rëndësisë dhe peshës specifike në vlerësim, kriteret ligjore ndahen në kategori dhe secila kategori zbërthehet në elementë më të hollësishëm vlerësues. Edhe shpërndarja e pikëve parashikohet sipas llojit dhe rëndësisë së secilës kategori, sikurse edhe sipas llojit e rëndësisë së atyre të elementëve që sipas ligjit e përbëjnë vlerësimin e kandidaturës për atë kategori vlerësimi.

Përtej këtij detyrimi, KED vlerësoi që, për qëllime të uniformizimit të qëndrimeve të tij dhe të transparencës së këtij procesi vlerësimi e pikëzimi, të përgatisë, miratojë dhe bëjë publike edhe një dokument tjetër rregullator të brendshëm mbi Metodologjinë që ndjek për vlerësimin dhe pikëzimin e kandidatëve, i cili është miratuar me vendimin e KED nr. 51 datë 21.06.2019.

Sipas kriterëve të vlerësimit dhe procedurave të sipërcituara të parashikuara në ligj dhe aktet nënligjore të nxjerra në bazë e zbatim të tyre nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, për qëllimet e vlerësimit dhe pikëzimit të secilës kandidaturë të lejuar, janë administruar dhe shqyrtuar dokumentacioni i paraqitur apo i përzgjedhur nga vetë kandidatët, si edhe dokumente e të dhëna të tjera të siguruar nga institucione publike e private, të kërkuara kryesisht nga ky Këshill.

Gjithashtu, në zbatim të pikës 5 të nenit 240 të ligjit nr. 115/2016, në mbledhje të organizuara për këtë qëllim, Këshilli ka realizuar intervistë me secilin kandidat të lejuar:

- *së pari* për tu njohur me motivimin e kandidimit, pikëpamjet dhe vizionin e kandidatit/es lidhur me gjykimin kushtetuese, veprimtarinë dhe sfidat e gjyqtarit dhe të Gjykatës Kushtetuese;
- *së dyti*, për të verifikuar cilësitë e kandidaturës në lidhje me elementë të tjerë të formimit të përgjithshëm profesional e qytetar etj.;
- *së treti*, për të vlerësuar nivelin e zotërimit të gjuhëve të huaja, me praninë e ekspertit të përzgjedhur nga radhët e trupës akademike të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja të Universitetit të Tiranës, duke zhvilluar për këtë qëllim, në një pjesë të intervistës, edhe bisedën mes ekspertit dhe kandidatit/es, në gjuhën e huaj të përzgjedhur nga vetë kandidati, duke e mbajtur parasysh mendimin me shkrim të ekspertit në vlerësimin e këtij kriteri ligjor.

Mbi këto baza të dhënash dhe veprimesh vlerësimi, për secilin kandidat, Këshilli ka vënë në bisedim shkallën e vlerësimit dhe masën e pikëzimit të secilit kriter ligjor vlerësimi. Çdo anëtar i Këshillit, duke filluar nga relatori i vendit vakant, për secilin kriter ligjor vlerësimi, ka parashtruar argumentet dhe arsyet ku mbështet shkallën e tij të vlerësimit dhe për të cilat ka çmuar ti caktojë pikët përkatëse kandidatit/es.

Në procedurën e vlerësimit dhe pikëzimit të kandidatëve për plotësimin e vendit vakant, vakancë e plotë, për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Kuvendi i Republikës në datën 04.03.2019, kanë marrë pjesë të gjithë anëtarët e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Pas dhënies së mendimit për shkallën e vlerësimit dhe masën përkatëse të pikëve për secilin kriter ligjor vlerësimi nga të gjithë anëtarët e Këshillit, rezultati përfundimtar i vlerësimit, për efekt të pikëzimit dhe renditjes së kandidatit, është përcaktuar nga shumatorja e pikëve të dhëna për secilin kriter ligjor vlerësimi nga çdo anëtar i Këshillit, i plotëpjestuar me numrin e anëtarëve të tij që kanë marrë pjesë në vlerësim.

Bazuar në diskutimin dhe mendimet e dhëna nga anëtarët e Këshillit lidhur me shkallën e vlerësimit të kandidatit/es për secilin kriter ligjor kandidimi, anëtari relator ka përgatitur vendimin e KED që përmban përshkrimin e hollësishëm të procedurës së ndjekur, si edhe arsyetimin e përbashkët të anëtarëve mbi shkallën e vlerësimit dhe të pikëzimit përkatës të meritave të kandidatit/es për secilin kriter ligjor vlerësimi.

Vendimet e KED për vlerësimin dhe pikëzimin e secilit kandidat të lejuar janë publikuar në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, pjesa e posaçme për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi. Ndërkohë, kopje të këtyre vendimeve, Tabelës Përmbledhëse të Pikëzimit si edhe të Dokumentit që përmban vlerësimet në pikë nga secili anëtar i Këshillit, i bashkëlidhen këtij Raporti.

Mbështetur në këtë procedurë vlerësimi dhe në vendimet e arsyetuara të vlerësimit e të pikëzimit të secilit kandidat, në zbatim të pikës 4 të nenit 7/c të ligjit të posaçëm me nr.8577/2000, relatori i vendit vakant ka përgatitur dhe paraqitur për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit listën përfundimtare të renditjes së të gjithë kandidatëve të lejuar për kandidim në vendin vakant të gjyqtarit në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e plotë, të shpallur nga Kuvendi i Republikës në datën 04.03.2019. Në mbledhjen e tij, Këshilli ka verifikuar saktësinë aritmetike të pikëzimit për secilin kriter dhe të pikëzimit në total për secilin kandidat sipas vendimeve përkatëse të vlerësimit.

Në pikën 4 të nenit 7/c të ligjit nr. 8577/2000 parashikohet se:

“Nëse ka më shumë se një vend vakant Këshilli harton dy lista të veçanta, një prej të cilave është me kandidatët që vijnë nga radhët e gjyqësorit....”

Nga ana tjetër, në aktin nënligjor normativ, Vendimi nr. 5 datë 02.04.2019 *“Për kriteret dhe procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, në dispozitat kalimtare, pika 80 është parashikuar që :

“80. Për vendet vakante që tashmë janë krijuar në Gjykatën Kushtetuese të cilat i përkasin të njëjtit organ emërtese, pavarësisht nga përcaktimet e pikës 69 të këtij Vendimi, duke mbajtur parasysh rrethanat e mungesës së njëhershmerisë në shpalljen e vendeve vakante, të kohës së tejzgjatur ndërmjet shpalljeve të konkurrimit për plotësimin e tyre dhe ekzistencën njëkohësisht të vendeve vakante me mandat të plotë dhe të pjesshëm, për të garantuar trajtimin e aplikimeve të kandidatëve në respektim të parimit kushtetues të barazisë përpara ligjit dhe të të drejtës së tyre të zgjedhjes së kandidimit për vende vakante të plotë ose të pjesshme, Këshilli do të procedojë me paraqitjen pranë organit përkatës të emërtesës të një liste të vetme përfundimtare të renditjes së kandidatëve sipas vendit vakant ku kanë shprehur interesin për kandidim.”

Për këtë arsye, bazuar në këtë rregull kalimtar të vendosur nisur nga rrethanat paparashikuara në ligj dhe që synojnë garantimin e barazisë së kandidatëve në konkurrim, në përfundim të veprimeve dhe procedurave të ndjekura për vlerësimin dhe pikëzimin e kandidaturave, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, ka proceduar me përgatitjen dhe miratimin e një liste të vetme përfundimtare të renditjes së kandidatëve të lejuar për kandidim për plotësimin e vendit vakant në Gjykatën Kushtetuese.

Prandaj, me vendimin nr. 134 datë 21.09.2019, pas verifikimit të saktësisë aritmetike të pikëzimit total për secilin kandidat sipas vendimeve përkatëse të vlerësimit dhe pikëzimit, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka miratuar listën përfundimtare të renditjes së të gjithë kandidatëve të lejuar për kandidim, në vendin vakant, vakancë e plotë, për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Kuvendi i Republikës në datën 04.03.2019, si më poshtë:

- | | |
|---------------------|-------------|
| 1) Arta Vorpsi | 89.642 Pikë |
| 2) Fiona Papajorgji | 88.785 Pikë |
| 3) Elsa Toska | 85.428 Pikë |

Bashkëlidhur këtij Raporti gjendet kopje e vendimit nr. 134 datë 21.09.2019 *“Për listën përfundimtare të renditjes së kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, në vendin vakant, vakancë e plotë, të shpallur nga Kuvendi i Republikës në datën 04.03.2019.”*

Gjithashtu, nëse do të vlerësohet nga organi i emërtesës, KED do të vendosë në dispozicion të tij, edhe kopje të plotë a të pjesshme të dokumentacionit të administruar dhe të shqyrtuar që përmban dosja e kandidimit të secilit kandidat të lejuar për kandidim dhe të vlerësuar nga ana e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Ky Raport është shqyrtuar dhe miratuar me vendimin nr. 135, datë 21.09.2019 *“Për miratimin e raportit për renditjen e kandidatëve të lejuar për plotësimin e vendit vakant të krijuar në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e plotë, të shpallur nga Kuvendi i Republikës në datën 04.03.2019”.*

KRYETARI

Ardian DËVORANI

